

A përfitoj
dëmshpërblim nëse
lirohem për shkak të
mbylljes apo
ristrukturimit?

Nëpunësit civilë që lirohen për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, në momentin e largimit përfitojnë dëmshpërblimin përkatës në përputhje me vjetërsinë në punë, sipas rasteve të mëposhtme:

- deri në një vit eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 1 muaji;
- nga 1 – 3 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 3 muajve;
- nga 3 - 6 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 6 muajve;
- nga 6 - 9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 9 muajve;
- mbi 9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 12 muajve.

**Kush janë të drejtat e nëpunësit pas
lirimit nga shërbimi civil, si pasojë e
ristrukturimit apo mbylljes së institucionit?**

Nëpunësit civilë, të cilët janë liruar nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit kanë të drejtë që, brenda periudhës 2 - vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil:

- të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë;
- të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil.



LIRIMI NGA SHËRBIMI CIVIL

Çfarë kuptojmë me lirim
nga shërbimi civil?

Lirimi nga shërbimi civil është
një nga rastet e përfundimit
të marrëdhënies së shërbimit
civil me nëpunës civil të çdo
kategorie.

Rruga: "Abdi Toptani",
ish-hotel "Drini", Tiranë
Tel: +355 4226 8141
info@kmshc.al; kmshc@kmshc.al
www.kmshc.al

Cilat janë shkaqet për lirim nga shërbimi civil?

Nëpunësi civil lirohet nga shërbimi civil për shkaqet si më poshtë:

- Për shkak të refuzimit të pajustificuar të nëpunësit për të pranuar transferimin e përhershëm.
- Si rezultat i mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, sipas pikave 6 dhe 7, të nenit 50, të ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
- Kur nëpunësi deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit.
- Pas dy vlerësimeve "jokënaqshëm", të rezultateve në punë.
- Kur nëpunësi ushtron të drejtën për pensionin e reduktuar të pleqërisë, sipas ligjit.
- Kur nëpunësi civil gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit, të deklaruar nga vetë nëpunësi dhe, sipas ligjit, nuk merr masat e parashikuara për shmangien e konfliktit të interesit brenda afatit të përcaktuar apo nëse transferimi në një pozicion tjetër nuk do të mënjanonte gjendjen e konfliktit të vazhdueshëm të interesit.
- Kur nëpunësi jep dorëheqjen nga detyra.
- Kur nëpunësi i nivelit të lartë drejtues anëtarësohet në një parti politike ose kur nëpunësit e niveleve të tjera bëhen anëtarë të organeve drejtuese të një partie politike.
- Në rast se anëtari i TND-së, i zgjedhur sipas pikës 5/1, të nenit 30, të ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nuk përfundon me sukses trajnimin në ASPA.
- Në rast se vlerësohet përsëri "jokënaqshëm" në përfundim të procedurës së rivlerësimit, sipas pikës 2/1 të nenit 62.
- Në çdo rast tjetër, të parashikuar nga ligji.
- Anëtari i TND-së lirohet nga shërbimi civil kur nuk është caktuar në një pozicion të rregullt për të paktën 8 muaj në një periudhë 5-vjeçare.

Kush e nxjerr aktin e lirit nga shërbimi civil

Lirimi i nëpunësit civil deklarohet me vendim të:

- Njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën.
- DAP-it për anëtarët e TND-së.

Cilat janë detyrimet e nëpunësit civil në rast largimi nga shërbimi civil?

- Të bëjë dorëzimin e plotë të dokumentacionit që administron për shkak të detyrës tek eprori i drejtpërdrejtë brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirit.
- Të bëjë dorëzimin e pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar të njësia përgjegjëse brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirit.

Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, afati i dorëzimit të detyrës, i dorëzimit të dokumentacionit, pajisjeve dhe mjeteve të punës në inventar, mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera.